

VENDIM
Nr. 456, datë 26.7.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION I RRUGËVE ‘NAFTËTARI’, ‘KRISTAQ LACKA’ DHE ‘QEMAL
STAF’”, BASHKIA KUÇOVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugëve ‘Naftëtari’, ‘Kristaq Lacka’ dhe ‘Qemal Stafa’”, Bashkia Kuçovë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall”, me sipërfaqe 532,3 m², “tokë arë”, me sipërfaqe 67 m², dhe “ndërtesë”, me sipërfaqe 279,61 m², me vlerë të përgjithshme 7 117 110 (shtatë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 117 110 (shtatë milionë e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e dhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Kuçovë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Kuçovë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Kuçovë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpro-nësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Kuçovë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Kuçovë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë dhe Bashkia Kuçovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT
 “RIKONSTRUKSION I RRUGËVE ‘NAFTËTARI’, ‘KRISTAQ LACKA’ DHE ‘QEMAL STAFA’”, BASHKIA
 KUÇOVË

N r.	Emri, mbiemri (pronari që shpronësohet)	Nr. i pasurisë	ZK	Sip. truall+ arë/m²	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sip. ndër timi m²	Çmimi i ndërtësë s lekë/m²	Vlera e ndërtësës lekë	Vlera totale	Shënime
1	Pëllumb Sina	11/668	2310	44	2,040	89760.0	59.6 1	32,317.0 0	1,618,190. 00	1,707,9 50.0	Konfirmim ZVRPP
2	Murat Benja	6/314	2310	87	2,040	177480. 0	126	32,317.0 0	1,993,623. 00	2,171,1 03.0	Konfirmim ZVRPP
3	Celnik Braho	9/447	2310	48	2,040	97920.0	92	32,317.0 0	2,348,800. 00	2,446,7 20.0	Konfirmim ZVRPP
4	Përparim Shkurti	11/53,11/5 77	2310	6	2,040	12240.0	2	32,317.0 0	49,768.00	62,008. 0	Konfirmim ZVRPP
5	Luljeta Brahimi	1046/15	2918	67 (tokë arë)	311	20,837.0				20,837. 0	Konfirmim ZVRPP
6	Dhimitër Bullari	9,/6	2310	228	2,040	465,120. 0				465,120 .0	Konfirmim ZVRPP
7	Sotiraq Bitri	11/235	2310	17	2,040	34,680.0				34,680. 0	Konfirmim ZVRPP
8	Arjan Qato	6/196	2310	21	2,040	42,840.0				42,840. 0	Konfirmim ZVRPP
9	Mihal Celaj	9,/7	2310	24	2,040	48,960.0				48,960. 0	Konfirmim ZVRPP
10	QPN Kuçovë	9/462	2310	50	2,040	102,000. 0				102,000 .0	Konfirmim ZVRPP
11	Vangjel Pjetri	6/197	2310	7.3	2,040	14,892.0				14,892. 0	Konfirmim ZVRPP
	Shuma që shpronësohet									7,117,11 0.0	